

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 246/1 Prot.

Vlorë, më 23.12.2020

RAPORTI VJETOR  
KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"  
VITI AKADEMIK 2019-2020

Raporti i detajuar vjetor i veprimtarisë së Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë" referuar vitit akademik 2019-2020, është hartuar nga Rektorati, në mbështetje të nenit 32 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor më Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimit të MASR nr. 5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", sipas elementeve përbërës të raportimit vjetor.

Raporti i detajuar vjetor i veprimtarisë së Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë" referuar vitit akademik 2019-2020, paraqitur nga Rektorati përpara Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, është një dokument rëndësishëm për veprimtarinë e kryer nga institucioni, në fushat akademike, shkencore, administrative dhe financiare. Ky dokument paraqet informacione të qarta, të plota dhe transparente të veprimtarisë së Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë", në zbatim të misionit të tij, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Raport paraqet për MASR dhe për çdo të interesuar, informacionin mbi gjendjen financiare të institucionit parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim, për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi të ofruara nga institucioni, si dhe elemente të tjera që lidhen me shërbimet që Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë" ofron.

Raporti i detajuar vjetor i veprimtarisë së Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë" referuar vitit akademik 2019-2020 është hartuar nga Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë" në 2 (dy) kopje origjinale në format hard-copy dhe një kopje elektronike, e cila përmban të dhënat e kërkuara nga Udhëzimi i MASR, nr. 5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", sipas pikave A. Senati Akademik dhe B. Bordi i Administrimit.

A. SENATI AKADEMIK:

a) Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planit strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së.

Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë" si institucion jopublik i arsimit të lartë, gjatë vitit akademik 2019-2020 ka përmbushur të gjitha objektivat e mësimdhënies, veprimtarisë së kërkimit shkencor dhe të inovacionit KUPV kryen vlerësime periodike të cilësisë së mësimdhënies, të programeve të studimit dhe të literaturës:

